



konformitetit për sigurinë kibernetike 1 (një) herë në vit, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës.

3. Të ardhurat e realizuara derdhen 100% në buxhetin e shtetit, në përputhje me vendimin nr. 432, datë 28.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijohen nga institucionet buxhetore”.

4. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 352, datë 25.6.2025

**PËR CAKTIMIN E ANËTARIT TË
EKIPIT PËRZGJEDHËS PËR
ZGJEDHJEN E KANDIDATËVE,
ANËTARË TË KOMISIONIT
KOMBËTAR RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Roven Metoja caktohet anëtar i ekipit përzgjedhës për zgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

2. Vendimi nr. 739, datë 4.12.2024, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e anëtarit të ekipit përzgjedhës për zgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të

Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 353, datë 25.6.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
PËR SIGURIMIN E
NDËRVEPRUESHMËRISË SË
PAJISJEVE RADIO TË AUTOMJETEVE
DHE MARRËSVE DIGJITALË TË
KONSUMATORIT¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 153, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 22, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për sigurimin e ndërveprueshmërisë së pajisjeve radio të automjeteve dhe marrësve digjitalë të konsumatorit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zbatimi i rregullave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi, nuk cenon zbatimin e kërkesave, të miratuara me vendimin nr. 378, datë 5.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Medias Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

¹ Ky vendim është përafuar pjesërisht me direktivën (EU) 2018/1972, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, “Për krijimin e Kodit Evropian të Faqe| 15452

Komunikimeve Elektronike”. Numri CELEX 32018L1972, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 321, datë 17.12.2018, f. 36-214.



RREGULLA
PËR SIGURIMIN E
NDËRVEPRUESHMËRISË SË PAJISJEVE
RADIO TË AUTOMJETEVE DHE
MARRËSVE DIGJITALE TË
KONSUMATORIT

Për sigurimin e ndërveprueshmërisë së pajisjeve radio të automjeteve dhe marrësve digjitalë të konsumatorit zbatohen kërkesat teknike, si më poshtë vijon:

1. Algoritmi i përbashkët “*scrambling*” dhe marrja e lirë e transmetimeve

Të gjitha pajisjet e konsumatorit, që hidhen në treg për shitje ose dhënie në përdorim, apo që bëhen të disponueshme në Republikën e Shqipërisë, me qëllim marrjen e sinjaleve televizive digjitale, përkatësisht, përmes transmetimit nëpërmjet rrjeteve tokësore, kablllore ose satelitore, duhet të jenë të afta për “*descrambling*” dhe:

a) të lejojnë ndarjen, dekodimin, mospërzierjen e sinjaleve digjitale, sipas një algoritmi të përbashkët evropian të ndarjes, kodimit, përzierjes së sinjaleve, që është miratuar si standard i harmonizuar i organizatave evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, në përputhje me ligjin për standardizimin;

b) shfaqin sinjalet që transmetohen në mënyrë të qartë, me kusht që, në rast se një pajisje e tillë merret në përdorim, qiramarrësi respekton marrëveshjen përkatëse të qirasë.

1.1 Me “*scrambling*” nënkuptohet teknika e përpunimit të sinjalit, që përdoret për të ndryshuar sinjalin, pa e humbur përmbajtjen, që ai të duket i rastësishëm dhe që mund të deshifrohet në anën e marrësit, nëpërmjet procesit “*descrambling*”.

2. Ndërveprueshmëria për pajisjet marrëse digjitale televizive

Çdo pajisje marrëse digjitale televizive me një ekran integral, me diagonale të dukshme më të madhe se 30 cm, që është hedhur në treg për shitje ose dhënie në përdorim kundrejt qirasë në Republikën e Shqipërisë, duhet të jetë e pajisur me të paktën një ndërfaqe të hapur të standardizuar ose në përputhje me një standard, të miratuar nga një organizatë standardizimi evropiane e njohur, apo në përputhje me një specifikim të gjerë industrial. Këto pajisje duhet të mundësojnë lidhjen e thjeshtë të pajisjeve fundore dhe të jenë në gjendje të kalojnë të gjitha elementet e sinjalit

digjital përkatës, përfshirë informacionin në lidhje me shërbimet ndërvepruese, interaktive dhe shërbimet e aksesit të kushtëzuar.

3. Ndërveprueshmëria për marrësit radio të makinave

Çdo pajisje marrëse radiomarrëse, e integruar në një automjet të ri të kategorisë M, që bëhet i disponueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë për shitje ose dhënie me qira, nga data 1 korrik 2026, duhet të përmbajë një radiomarrës të aftë për marrjen dhe riprodhimin e shërbimeve radio të ofruara nëpërmjet transmetimit radio tokësore digjitale. Marrësit, që janë në përputhje me standardet e harmonizuara, të publikuar në Fletoren Zyrtare ose në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, konsiderohen se janë në përputhje me kërkesat e këtyre standardeve ose pjesëve të tyre.

3.1. Automjeti i kategorisë M përcaktohet në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

4. Kërkesat sipas pikës 3, të këtyre rregullave, nuk i pengojnë marrësit radio të makinave në automjetet e reja të kategorisë M të mundësojnë marrjen dhe riprodhimin e shërbimeve radio të ofruara nga ofruesit e shërbimit audio/radio me rrjete tokësore analoge. Radiomarrësit e integruar në automjete do të sigurojnë marrjen e sinjalit radioanalog, për sa kohë shërbimi radiodigjital nuk është ofruar.